



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 248, datë 25.11.2019

PËR CAKTIM NË POZICION TË PËRKOHSHËM

Mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neneve 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit 115 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, me propozim të Komisionit Për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë;

V E N D O S I:

1. **Z. Altin Dumani**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, të vazhdojë të ushtrojë përkohësisht detyrën si Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Për Krimet e Rënda Tiranë.
2. Z. Altin Dumani do të ushtrojë detyrën si Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Për Krimet e Rënda Tiranë, përkohësisht nga data 25.11.2019-19.12.2019.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, z. Dumani do të paguhet me pagën e pozicionit të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Për Krimet e Rënda Tiranë.
4. Të njoftohen me këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, z. Altin Dumani, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Për Krimet e Rënda Tiranë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GËNT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
ARBEN DOLLAPAJ

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
BESNIK CANI